



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0051455-1/23 dt. 17.07.2023

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 20

Koha: 17.07.2023 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shosholli Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Drejtorët e Drejtorive

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; neni 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e njëzetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja theksoi se me e-mail ju kanë ardhur edhe materiali për dy pika shtesë, Propozim-vendimi për subvencionimin e familjeve raste sociale, dhe Draft-rregullorja për ndarjen e bursave për nxënësit e SHMT “Arkitekt Sinani”.

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim propozimin që pikë e 5 e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi për subvencionimin e familjeve raste sociale.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht (9 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime) vendosi që pikë e 5 e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi për subvencionimin e familjeve raste sociale.

Kryesuesja vuri në votim propozimin që pikë e 6 e rendit të ditës të jetë: Draft-rregullorja për ndarjen e bursave për nxënësit e SHMT “Arkitekt Sinani”.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht (9 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime) vendosi që pikë e 6 e rendit të ditës të jetë: Draft-rregullorja për ndarjen e bursave për nxënësit e SHMT “Arkitekt Sinani”.

Në vazhdim Kryesuesja vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim vendim për lejimin e shpalljes së konkursit publik për subjektet afariste të interesuara për t’u vendosur në “Parkun Industrial” në Frashër – Zona Ekonomike në Mitrovicë
3. Propozim vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste për t’u vendosur në Zonën e Lirë Ekonomike në Frashër, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik
4. Propozim vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim në Zonën e Lirë Ekonomike, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik
5. Propozim vendim për subvencionimin e familjeve raste sociale
6. Draft rregullore për ndarjen e bursave për nxënësit e SHMT “Arkitekt Sinani”
7. Raporti financiar për realizimin e buxhetit komunal janar-qershor 2023

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e 19 u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim vendimin për lejimin e shpalljes së konkursit publik për subjektet afariste të interesuara për t’u vendosur në “Parkun Industrial” në Frashër – Zona Ekonomike në Mitrovicë, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtorit të DGJKP-së z. Artan Berisha.

Artan Berisha: Me këtë propozim-vendim kemi propozuar shpalljes së konkursit publik për dhënien në shfrytëzim të 3 parcelave për subjektet afariste të interesuara për t’u vendosur në “Parkun Industrial” në Frashër – Zona Ekonomike në Mitrovicë, mirëpo për shkak të disa çështjeve administrative e tërheqim pikën 2.2, ndërsa pikat tjera të materialit mbesin për shqyrtim, ndërsa materiali për Kuvend do të procedohet pa pikën 2.2.

Hysen Muzliukaj: A ka mundësi ta dimë numrin e saktë të kërkesave për t’u vendosur në Parkun Industrial.

Fadil Veseli: Zona Ekonomike në Mitrovicë u krijua me hapa të shpejtë, filloi menjëherë dhëna në shfrytëzim e pronave, qëllimi për të cilën u krijua kjo zonë asnjëherë nuk u arrit për shkak të problemeve me infrastrukturë e cila nuk u rregullua asnjëherë në atë pjesë, komuna nuk patë mundësi të investojë e Ministritë e linjës nuk qenë serioze në

investim. Edhe pse më shumë se 20 kompani morën prona në shfrytëzim në atë pjesë dhe u nënshkruan kontratat me të, ato nuk qenë serioze, vetëm një kompani është aktive në atë pjesë. Ne nuk i kemi parë kontratat e nënshkruara e as nuk i dimë obligimet e komunës që i ka marrë me ato kontrata, por kërkoj që kompanitë që nuk kanë investuar në pronat që kanë marrë në shfrytëzim dhe ata që nuk kanë filluar të punojnë asgjë në këto prona t’iu merren pronat dhe t’iu ipen atyre që punojnë.

Artan Berisha: Sa i përket pyetjes që shtroi z. Muzliukaj, ju informoj se kërkesa për tu vendosur në atë zonë ka të shumta, ka kërkesa serioze prej pronarëve të fabrikave të ushqimit dhe higjienës. Infrastruktura në atë pjesë është duke u zhvilluar, ata që nuk kanë investuar po tërhiqen, Komisioni që do të formohet do t’i vlerësoj të gjitha.

Kryetari Bedri Hamza: Me këtë propozim-vendim ne dëshirojmë të krijojmë parakushtet për shpalljen e konkursit publik për subjektet afariste të interesuara për t’u vendosur në “Parkun Industrial” në Frashër, aplikojnë ata që kanë interesim, infrastrukturën kemi filluar ta zhvillojmë, si Komunë nuk kemi kapacitet ta përfundojmë menjëherë, presim ndihmë edhe nga niveli qendror, qëllimi është të fillojmë me këtë proces dhe ta t’i mbështesim bizneset.

Hysen Muzliukaj: Pyetja ime ke konkrete, sa është numri i kërkesave për t’u vendosur në atë pjesë?, sepse kur jemi në këtë pikë ne nuk kemi asnjë dallim, të gjithë jemi të interesuar t’iu ndihmojmë sa më shumë, unë e di se në atë zonë janë më shumë se dy biznese janë aktive në atë pjesë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për lejimin e shpalljes së konkursit publik për subjektet afariste të interesuara për t’u vendosur në “Parkun Industrial” në Frashër – Zona Ekonomike në Mitrovicë.

Propozim vendimi për lejimin e shpalljes së konkursit publik për subjektet afariste të interesuara për t’u vendosur në “Parkun Industrial” në Frashër – Zona Ekonomike në Mitrovicë u miratua unanimitisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja znj. Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për formimin e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste për t’u vendosur në Zonën e Lirë Ekonomike në Frashër, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për formimin e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste për t’u vendosur në Zonën e Lirë Ekonomike në Frashër, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik.

Propozim vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste për t’u vendosur në Zonën e Lirë Ekonomike në Frashër, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik **u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Pikat 4

Kryesuesja znj. Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim në Zonën e Lirë Ekonomike, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim në Zonën e Lirë Ekonomike, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik.

Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim në Zonën e Lirë Ekonomike, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim vendimin për subvencionimin e familjeve raste sociale, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DMS-së znj. Drita Ibrahimimi.

Pas arsyetimit të shkurtë të propozim-vendimit nga Drejtoresha Drita Ibrahimimi, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Hysen Muzliukaj: Numri i familjeve që do të përfitojnë këtë ndihmë sociale me propozim-vendim është paraparë të jetë 2066, u tha se ka zbritje të numrit të rasteve sociale, a mund ta dimë se sa është zbritja, dhe po ashtu më intereson të di se pse në këtë muaj është menduar të ipen këto mjete.

Kryetari Bedri Hamza: Mitrovica ka numrin më të madh të rasteve sociale në Kosovë, kjo është si pasojë e zhvillimeve ekonomike, sociale e politike. Vitin e kaluar është paraparë të ndihmohen 2100 familje me nga 100 €, por vitin e kaluar kanë aplikuar vetëm 1900, sepse kur kanë aplikuar vetëm kaq i kanë plotësuar kriteret. Sa i përket pyetjes pse është menduar që këtë muaj të ndihmohen, arsyeja është sepse këto mjete mendohet të dalin në xhironlogaritë e përfituese në shtator sepse është koha kur fillon viti shkollor, drutë, dhe përgatitjet tjera për dimër.

Hysen Muzliukaj: Dallimi prej 200 familjeve më pak prej atyre që është dashur të marrin ndihmën financiare dhe atyre që kanë marrë është shqetësuese, a duhet që DMS-ja të kontaktojë personat përgjegjës në institucionin ku merret asistenca sociale dhe të dihet saktë ku është problemi sepse në listat e përfituesve të asistencës sociale është ky numër i dhënë është më i madh, e kur kriteret për të marrë ndihmën financiare nga komuna janë të njëjta me kriteret për asistencën sociale, ndërsa numri i përfituesve në Komunë është më i vogël për 200.

Kryetari Bedri Hamza: Kur kemi dashur që pagesat t'i bëjmë përmes postës familjet kanë hezitur me i hapë llogaritë, janë frikësuar se mos po i'u ndalet asistenca sociale. Ne i kemi marrë të gjitha hapat e nevojshëm për mos t'iu ndërprerë asistenca sociale, tash të gjitha pagesat po u dalin përmes llogarive bankare.

Xhyljeta Imeri: Një prej arsyeve pse është numri më i vogël i aplikuesve është mungesa e informimit dhe niveli i arsimimit, ka prej këtyre familjeve që nuk dinë as ku janë bankat, as të aplikojnë. Ju përgëzoj për këtë punë dhe shpresoj që ky subvencionim të bëhet 2 herë në vit.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për subvencionimin e familjeve raste sociale.

Propozim vendimi për subvencionimin e familjeve raste sociale u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 6

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Draft rregulloren për ndarjen e bursave për nxënësit e SHMT “Arkitekt Sinani”, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Pas arsyetimit të draft-rregullores nga Kryetari Bedri Hamza, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Neni 4 duhet me qenë më i përpunuar dhe më praktik, sepse është i përfshirë në mënyrë të përgjithshëm, p.sh. nxënësit e shkëlqyeshëm vlerësohen me 5, nxënësit me sukses shumë mirë vlerësohen me 4, etj., në këtë formë siç është paraparë Komisioni e ka shumë të vështirë të bëjë përzgjedhjen e përfituesve, propozoj që përveç vlerësimit të notave me pikë të bëhet edhe vlerësimi i viteve shkollore, p.sh. viti i parë me 1 pikë, viti i dytë me 2 pikë e kështu me radhë, familjet e dëshmorëve të kenë në start plus 1 pikë, familjet në asistencë sociale të kenë plus 1 pikë, po ashtu me pikë t’iu ipet përparësi edhe drejtimeve deficitare. Nga Komuna të bëhen të gjitha përpjekjet që nxënësit e kësaj shkolle të aftësohen përmes praktikës, të kërkohet edhe nga Ministria mbështetje që të gjitha drejtimet të kenë kabinetet për praktikë dhe të dalin kuadro për tregun e punës.

Shkurta Shosholli Musa: Kolegëve në arsim iu kam ofruar si mostër Rregulloren për ndarjen e bursave për studentë, kjo rregullore klasifikimin e pikëve e bënë në formë tabelore, unë mendoj se edhe në draft-rregulloren që po e shqyrtojmë do të ishte mirë që të bëhet klasifikimi i pikëve në formë tabelore. Rregullorja që po shqyrtojmë ka për qëllim dhënien e bursave për nxënësit e SHMLT, dhe sigurisht që DKA ka politikë afatgjate vënien në funksion të të gjitha drejtimeve në formë homogjene, prandaj konsideroj që përveç notës mesatare, rasteve sociale, absolutisht mbështetjes së familjeve të kategorive të dala nga lufta, një klasifikim bazuar në drejtimet sipas rëndësisë së tyre është po ashtu shumë i nevojshëm. Shkolla Teknike asnjëherë nuk ka pasur mbështetje më të madhe se sa që ka sot, një numër i kabineteve veç janë vënë në funksion. DKA në bashkëpunim me GIZ-in gjerman po bënë përpjekje të jashtëzakonshme në fushën e praktikave profesionale dhe realizimit të tyre në vendin e punës. Kërkesë që e kam parashtruar kur është diskutuar rregullorja për subvencione është që studentëve me mundësi të dobëta financiare t’iu paguhet transporti ose të bëhet një transport i organizuar i nxënësve për arsye se edhe Shkolla Teknike dhe Shkolla Ekonomike praktikat po i realizojnë në vendet e tyre të punës, dhe kjo është një vull mbështetëse e jo vetëm fjalë goje siç ka qenë më herët.

Hysen Muzliukaj: Ideja për dhënien e bursave nxënësve të kësaj shkolle është që t’iu ipet mundësia për tu regjistruar në këtë shkollë e jo për nxënësit që vijojnë mësimin. Kjo rregullore nuk e parasheh atë që ne po dëshirojmë, në bazë të kësaj ne në start i eliminojmë

ata që duan të regjistrohen, ky nuk është qëllimi ynë, nxënës të shkëlqyeshëm në atë shkollë nuk ka, Komisioni që e ka hartuar këtë draft ka dalë prej asaj çka është kërkuar, pra po e përsëris edhe njëherë qëllimi për dhënien e bursave është për nxënësit që duan të regjistrohen në këtë shkollë.

Xhyljeta Imeri: Kjo rregullore ka ardhur për miratim me vonesë, regjistrimi në shkolla të mesme veçse ka filluar, unë konsideroj se kjo rregullore duhet të punohet me kujdes dhe të shërbejë për vitet vijuese. Pajtohem me parafolësit si për kriteret ashtu edhe për vlerësimin. Për nxënësit e kësaj shkolle është e nevojshme të investohet si nga niveli lokal edhe nga niveli qendror. Është mirë të bëhen video promovuese në të gjitha rrjetet sociale ku do të tregohet rëndësia e këtyre drejtimeve për tregun e punës, si dhe sukseset që kanë pasur nxënësit në këto drejtime. Është bërë një hap i madh në përkrahje të kësaj shkolle, por ende ka vend për përmirësim.

Kryetari Bedri Hamza: E tërheq këtë pikë nga rendi i ditës, ky draft i rregullores duhet të korrigjohet dhe të përmirësohet sepse është mjaft kufizues, vërtetë ka dalë prej asaj për çka ka qenë qëllimi, qëllimi ynë është t'i nxisim nxënësit të regjistrohen në këtë shkollë, prandaj e tërheq pikën dhe në mbledhjen e radhës së KPF-së dhe Kuvendit do ta sjellim për shqyrtim draft-rregulloren e përmirësuar.

Pika 7

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Raportin financiar për realizimin e buxhetit komunal janar-qershor 2023, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Pas arsyetimit të Raportit financiar për realizimin e buxhetit komunal janar-qershor 2023 nga Kryetari Bedri Hamza, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Në aspektin e të hyrave është pozitive se me raport financiar secila drejtori e sheh punën që e ka bërë, inkasimi i të hyrave vetanake sipas drejtorive krahasim me planifikimin rezulton afër 40%, kjo nuk është e kënaqshme por as alarmante, ndërsa te investimet kapitale është tjetër dinamikë sepse deri në muajin mars mjetet financiare janë të bllokuara, pastaj fillojnë alokimet, tenderët, procedurat e prokurimit, prandaj ky gjashtëmujor është më pak i pasur. Një goditje e cila nuk po na lëshon është ajo e ekzekutivit të kaluar, sepse hiq më pak se 259.000 € na janë bartë këtë vit obligime të Ekzekutivit të kaluar për dobësitë dhe mangësitë e tyre.

Xhyljeta Imeri: Po shihet se në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë realizuar vetëm 39% e asaj që është planifikuar, realisht nuk është e kënaqshme, por presim në muajt në vijim të ketë përmirësim. Në disa drejtori ka rritje të realizimit e disa zvogëlim. Te investimet kapitale është shumë shqetësuese realizimi vetëm 11% i planifikimit, këtu direkt preken nevojat dhe interesat e qytetarit, por po shpresojmë se në muajt në vijim do të ketë rritje të realizimit. Është e pa kuptimtë se 90% e buxhetit në DAP janë investuar për rregullimin e Komunës, ndërsa nuk kanë qenë në gjendje të ndajnë në shumë të vogël të mjeteve financiare për karrige në Sallën e Mediave. Gjithashtu dua të ngris një shqetësim të qytetarëve dhe timin personal, fjala është për rregullimin e rrugës “Mbretëresha Teutë”, që realisht është ngushtim i kësaj rruge, ju lus ta merrni seriozisht këtë shqetësim dhe të bëni rishikimin e projektit, sepse do të ketë pasoja afatgjate. Paramendoni nëse dy shiritat janë komplet të ngarkuar a është menduar se ku do të jetë makina e tretë në raste emergjente

si policia, autoambulanca, zjarrfikësit, etj., ky është një shqetësim i madh i të gjithë qytetarëve, unë kam marrë mendime edhe nga profesionistët, ky projekt duhet të rishikohet.

Hysen Muzliukaj: Në përfundim të vitit 2022 kam pyetur Drejtoreshën e DBF-së a po kryhen të gjitha borxhet, më është thënë se po të gjitha, ndërsa tash po del se ende nuk janë kryer. Sa i përket buxhetit vetëm 2 drejtori e kanë kaluar 50% e inkasimit, ideja që prej 11% të inkasimit në gjashtëmujorin e parë të arrijë në 50% në gjashtëmujorin e dytë nuk ka asnjë teori. Te urbanizmi, thuhet se s'ka inkasim ndërsa në qytet po punohet, një volum goxha i madh i punës. Te shërbimet kulturore a e paraqet kjo krejt DKRS-në, këtu janë inkasuar vetëm 71 € ndërsa janë planifikuar 13.000 €, ne duhet të reagojmë këtu, kjo është tepër pak. Te Inspeksioni inkasimi është 17.53%, ndërsa i kemi planifikuar 156.000 €, Bujqësia 41%, Drejtorja e Arsimit a ka ndonjë inkasim, a ka ndonjë të hyrë, a është planifikuar diçka, ne jemi në përfundim të muajit 7 dhe nëse ne mendojmë se ky inkasim ka gjasa me u rritë aq shumë, unë për vete nuk kam parë këso teorie. Unë mendoj se është një prej raporteve më të dobëta në vitet e fundit sa i përket inkasimit, prandaj gjendja është alarmante dhe secili drejtor duhet të reflektojë.

Valdete Idriçi: DKRS është prej drejtorive që është goditur më së shumti nga vërshimet, 3 sallat nga ku kemi planifikuar të gjenerojmë të hyra janë dëmtuar nga vërshimet dhe për momentin janë të pashfrytëzueshme, terminët në palestrën Minatori janë pa pagesë dhe janë të gjitha të zëna, disa shfaqje teatrale po ashtu janë pa pagesë, prandaj ky inkasim kaq i vogël është si pasojë e goditjeve të objekteve të DKRS-së nga vërshimet.

Igballe Islami: Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2023 është i bazuar në gjendjen reale, inkasimi i të hyrave është i vogël në këtë periudhë por ne kemi marrë hapa konkret drejt mbledhjes së detyrueshme të të hyrave. Borxhet nga vitet e kaluara të gjitha janë të publikuara në ueb faqen e Komunës, kemi obligime të pa kryera që nga viti 2019 deri në vitin 2021, secila drejtori duhet të reflektojë në pjesën e përgjegjësive të veta, unë besoj se raporti janar-shtator 2023 do të jetë me përqindje shumë më të kënaqshme të inkasimit.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Raportin financiar për realizimin e buxhetit komunal janar-qershor 2023.

Raporti financiar për realizimin e buxhetit komunal janar-qershor 2023 u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:45 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETANI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA